



Albanisch

Qarkullimi me biçikletë në Gjermani

Rregullat kryesore

Mirë se erdhët në Gjermani

Qarkullimi me biçikleta është shumë i popullarizuar në Gjermani. Në mënyrë që ju të jeni sa më të sigurtë që është e mundur nëse qarkulloni me biçikletë, kemi përmblodhur [rregulat kryesore të sjelljes](#).





PËRMBAJTJA

Rregullat e përgjithshme të komunikacionit	6
Rregullat kryesore për çiklistët	7
Rrugët për çiklistët	9
Sjelljet e përshtatshme në udhëkryqe	12
Rreziqe të veçanta	14
Në rast aksidenti	16



Rregullat e përgjithshme të komunikacionit



ANA E DJATHE NE KOMUNIKACION

Qarkulloni në këndin e djathtë të shtegut të çiklistëve. Mbanini distancën me automjetet e parkuara. Tejkaloni veturat e tjera majtas edhe në shtigjet e posaçme për çiklistët.



E DREJTA E PËRPARËSISË „ANA E DJATHTË PARA ANËS SË MAJTË“

Në udhëkryqe vlen rregulla e përparësisë „**ana e djathtë para anës së majtë**“ në rast se nuk ka shenja të komunikacionit apo semaforë të cilët përcaktojnë rregulla të tjera.

Udhëkryqet dhe kryqëzimet të cilat dallohen me vështiresi janë të shenjuar me shenja të posaçme dhe edhe aty vlen rregulla e përparësisë “ana e djathtë para anës së majtë”.



Udhëkryqi apo kryqëzimi me të drejtë përparësie nga ana e djathtë

SHENJAT E PËRPARËSISË



Jep përparësi



Ndalo! Jep përparësi

Kur ekzistojnë këto shenja të komunikacionit ju duhet t'i jepni përparësi **automjeteve të tjera**, dhe të prisni.



Përparësi



Rrugë me përparësi kalimi

Kur ekzistojnë këto shenja të komunikacionit, **shoferët e tjerë** duhet t'ju japin juve përparës.

Rregullat kryesore për çiklistët

- ▶ Bçikleta duhet të jetë e pajisur me drita, frena dhe zile
- ▶ Biçikletën mund ta ngas vetëm një person.



Fëmijët e vegjël duhet të vendosen vetëm në **ulësen e fëmijëve** ose në rimorkio speciale.



Mbani të dy duart në timon.



Qarkulloni njëri pas tjetrit.



Mundësisht pajisuni me helmet.



Çiklistët nuk kanë të drejtë të mbahen në veturat e tjera.



- ▶ Ju duhet të respektoni rregullat e komunikacionit. Edhe çiklistët ndalohen nga policia dhe marrin dënime/gjoba.



Mos telefononi gjatë qarkullimit me biçikletë dhe as mos shikoni në smartfonin tuaj.



Mos qarkulloni me biçikletë nëse keni.

Shtigjet e Çiklistëve

Biçikleta është mjet udhëtimi prandaj parimisht e ka vendin në rrugë. Fëmijët **deri në moshën tetë vjeçare duhet të qarkullojnë në shtegun e këmbësorëve**. Fëmijët **deri në moshën dhjetë vjeçare kanë të drejtë** ende ta përdorin shtegun e këmbësorëve për qarkullim me biçikletë.



Shtegu për biçikleta ndahet nga rruga e automjeteve nga një trotuar dhe nga rruga e këmbësorëve përmes shenjësimit, flasterit apo trotuarit të ulët.

Linja e shtegut për biçikletat është e tërhequr në tokë, dhe është e bardhë ku është e vendosur shenja e kaltër e **rrugës për biçikleta**. Ky shteg nuk kalohet me automjete.



Linja mbrojtëse është vendosur me ndërprerje në rrugë dhe e shenjuar me një piktogram të biçikletës. Në këtë rrugë automjetet mund të kalojnë vetëm nëse i shmangen trafikut të përballëkalimit.



Ekzistojnë edhe **rrugë të përbashkëta për këmbësorë dhe çiklistë**. Në këtë rast çiklistët duhet të jenë posaçërisht të kujdesshëm ndaj këmbësorëve

Këtu **duhet** të vozisin çiklistët:



Shtegu për
biçikleta /
Korsi për
biçikleta



Shtegu i përbashkët për
këmbësorë dhe
çiklistë



Shtegu për çiklistë afër rrugës
për këmbësorë

Posa të shihni një shteg me **biçikletë të bardhë në shenjë e kaltër** duhet ta shfrytëzoni atë shteg, përjashtoj rastin nëse hasni në pengesa. Në këtë rast mund të kaloni me kujdes në shteg. Nëse nuk ka mundësi të kalohet në shteg ju duhet të zbrisni dhe ta tejkaloni pengesën duke e shtyrë biçikletën.

Rrugët për biçikleta pa shenja **mund, por nuk duhet** detyrimisht të shfrytëzohen. Këtu ju mund të qarkulloni në rrugë.



Shenja shtesë
„Rrugë e hapur
për çiklistë“

Këto rrugë janë për **çiklistë**:

Sipërfaqet e tjera (p.sh. rruga për këmbësorë, vendkalimet e këmbësorëve) mund të shkelen vetëm nëse në to është e vendosur **shenja shtesë** „rrugë e hapur për biçikleta“.

Pa shenjën shtesë „Rrugë e hapur për çiklistë“ **duhet të zbrisni nga biçikleta dhe ta shtyni atë.**



Këtu **ndalohet** qarkullimi me biçikleta:



Rruga e
automje-
teve



Autostrada



Ruga e
këmbë-
sorëve



Nda-
lesë për
trafikun
e biçikle-
tave



Ndalesë e
të gjitha
llojeve të
automje-
teve




Sjellja e përshtatshme në udhëkryqe

SEMAFORAT


Edhe me biçikletë ju duhet të respektoni **semaforin**.



Kur ngjyra e semaforit është e gjelbërt, ju keni të drejtë qarkullimi, por me kujdes.



Kur ngjyra e semaforit është e verdhë, ju duhet të ndaleni dhe nuk keni të drejtë qarkullimi.



Kur ngjyra e semaforit është e kuqe, ju duhet të ndaleni gjithmonë.



Kur ekzistojnë **semaforë specialë për biçikleta**, atëherë duhet t'i respektoni ato.

Nganjëherë psh. kur nuk funksionon semafori, atëherë duhet të respektohet **policia e cila e rregullon** komunikacionin. Shenjat me dorë të policëve kanë gjithmonë përparësi.



Tani mund të niseni por me kujdes.



Kujdes! Para se të arrini në udhëkryq prisni shenjën tjetër.



Ndal!



KUJDES NË KTHESA

Kështu ju ktheheni në mënyrë të sigurtë:

- ① **Shikimi përmes krahavorit:** Shikoni fillimisht mbi krahavorin tuaj dhe vështrojeni mirë komunikacionin



Jepni shenjë me dorë: Tregoni në mënyrë të qartë me dorë se në cilin drejtim dëshironi të ktheheni.

- ③ **Klasifikimi :**
 - Nëse ekziston udhëzuesi për komunikacionin e biçikletave, atëherë ndiqni ato.
 - Rendituni me kohë para arritjes në udhëkryq në shiritin e duhur.
- ④ **Kthesa :** Gjatë kthimit djathtas kini kujdes këmbësorët të cilët njëkohësisht kalojnë rrugën sepse ata kanë përparësi. Në kthesa në anën e majtë, gjithmonë kanë përparësi mjetet të cilat janë në përballëkalim. Nëse ekziston shenjëzimi adekuat për biçikleta, atëherë ndiqni atë.

KTHESA INDIREKTE

Nëse ndjeni pasiguri në kthesa në anën e majtë, atëherë mund të ktheheni edhe në mënyrë indirekte.

- ① Shkoni fillimisht drejtë deri sa të keni kaluar udhëkryqin.
- ② Ndaluni në anën e djathtë në skaj të rrugës, ku në rast nevojë duhet edhe të zbrisni.
- ③ Prisni deri sa të lirohet rruga, pastaj kaloni rrugën dhe vazhdoni.



Rreziqet e veçanta

„KËNDI I VDEKUR“

Çiklistët janë posaçërisht të rrezikuar, kur veturat ose kamionët kthehen në anën e majtë. Në të ashtuquajturin **Këndi i vdekur** drejtuesi nuk sheh mirë apo fare



Qarkulloni me kujdes. Nëse keni dyshime hiqni dorë nga përparësia juaj apo zbrisni dhe kaloni në rrugën për këmbësorë. Por aty duhet ta shtyni bicikletën.

Prandaj :

- ▶ Mbani gjithmonë distancën **prapa një autobuzi apo ka- mioni**, asnjëherë mos udhëtoni afër tyre apo menjëherë prapa.
- ▶ Një kamion apo një autobuz ka nevojë për hapësirë. **Mbani distancë.**
- ▶ Qarkulloni me kujdes. Në rast se keni dyshime hiqni dorë nga përparësia e juaj.
- ▶ Qarkulloni afër veturave vetëm atëherë kur të keni hapësirë të mjaftueshme.
- ▶ Mbani **kontaktin me sy me qarkulluesin.**



RREZIQE TË TJERA

Në rrugë të përbashkëta për këmbësorë dhe biçikleta **udhëtoni me kujdes të shtuar**, dhe vetëm me atë **shpejtësi sa të mund të frenoni dhe të ndaloni në çdo kohë**. Përshtatëni shpejtësinë tuaj me këmbësorët.

Përveç kësaj drejtuesit e automjeteve mund edhe të mos ju shohin në **kthesa dhe rrugëdalje në pronat tokësore**.

Mbani distancën me **veturat e parkuara**, sepse papritur mund të hapen dyert.

Në rast të Aksidentit

Në rast të aksidentit kërkonti ndihmë. Asnjëherë mos u largoni nga vendi i ngjarjes pa e lajmëruar rastin, sepse kjo paraqet vepër të dënueshme.



Kontaktoni numrin
112
të qendrës koordinuese
të shpëtimit.
të emergjencës.

Në këtë numër mund
të kontaktoni edhe pa
pasur kredi në telefon.

Qendra koordinuese e shpëtimit, do t'ju parashtroj këto pyetje:

Ku ka ndodhur rasti?

Çka ka ndodhur saktësisht?

Sa persona janë prekur?

Çfarë lëndimesh kanë pësuar, nevojat e tyre?

Do të keni edhe pyetje të tjera!

Prisni ndihmën e shpejtë dhe patrullën e policisë për t'i njoftuar lidhur me rastin.

Nëse ju nuk jeni në gjendje të telefononi, **informoni të tjerët lidhur me rastin e ndodhur**, në mënyrë që të kërkojnë ndihmë.

INFORMATA RRETH NESH

Publikuar nga:



**Unfallforschung der Versicherer
(UDV- Hulumtimet e aksidenteve të të siguruarve)**

Wilhelmstraße 43/43 G, 10117 Berlin

Fahu postal 08 02 64

10002 Berlin

www.udv.de, www.gdv.de



**Deutsche Verkehrswacht e.V.
(Asociacioni Gjerman i Mbikëqyrjes dhe sigurisë së trafikut)**

Budapester Straße 31

10787 Berlin

www.deutsche-verkehrswacht.de



**Deutscher Verkehrssicherheitsrat
(DVR – Këshilli Gjerman i Sigurisë rrugore)**

German Road Safety Council

Auguststraße 29

53229 Bonn

www.dvr.de

Redaksia:

Klaus Brandenstein (UDV)

Jörg Ortlepp (UDV)

Kay Schulte (DVR)

Daniel Schüle (DVW)

Koncepti+ dhe dizajni

pensiero KG, www.pensiero.eu

Burime fotografike:

Kopetina: connel_design – fotolia.com;

Fq. 3: cbskchristine – fotolia.com;

Fq. 7: Avanne Troar;

Fq. 8: Picture-Factory – fotolia.com;

Fq. 11: Christian Müller – fotolia.com;

Fq. 12 (milieu): Kara – fotolia.com;

Fq. 16: Tobias Arhelger – fotolia.com;

Të drejtat e shfrytëzimit të fotografive të shfaqura në këtë broshurë janë për hulumtime të aksidenteve të personave të siguruar përkatësisht në Këshillin e Sigurisë rrugore në Gjermani

Botimi në gjuhën shqipe

Këtë broshurë mund ta gjeni edhe
në gjuhë të tjera pa pagesë.

Shkarko këtu:

www.germanroadsafety.de

